

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja: Fillim Skoro, kryetar, Have Haliti dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesionale, Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.F. nga fshati ..., Komuna e Drenasit, me vendbanim të përhershëm në Belgjikë, për shkak të veprës penale, blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë dhe përgjigjen ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. R.K., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.155/15 të datës 30.05.2017, në seancën e kolegjit me datën 10.08.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.155/15 i datës 30.05.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore DKR në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.155/2015, të datës 30.05.2017, të akuzuarin B.F., e ka shpallur fajtor për veprën penale, posedimi, i pa paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, për të cilën vepër penale e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, nuk kryen vepra tjera penale, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) euro, të cilën gjobë e ka obliguar ta paguajë në afat prej 3 muajve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, të njëjtit gjoba i zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro, i llogaritet një ditë burgim.

Të akuzuarin e ka obliguar t'i paguajë shpenzimet e procedurë penale sipas llogarisë së gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të akuzuarit gjykata ja ka konfiskuar substanca narkotike të llojit kanabis (marihuanë) në peshë të përgjithshme prej

7.67 gram, si dhe ka urdhëruar që substanca narkotike e konfiskuar nga ana e të akuzuarit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohet.

Gjykata ka urdhëruar kthimin e sendeve të akuzuarit, automjetin e markës 'Golf IV', ngjyrë hiri me targa CMU-682, pronë e XH.K., paratë e gatshme në shumë prej 780 (shtatëqind e tetëdhjetë) euro dhe telefonin celular Iphone 6.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta anulojë, lëndën të kthej në rivendosje ose aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarin ta shpallë fajtor sipas aktakuzës dhe t'i konfiskohet automjeti 'Golf IV', si dhe paratë që janë gjetur te i akuzuari.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. R.K., ka bërë përgjigje në ankesën e prokurorisë, ka propozuar që Gjykata e Apelit të refuzoj si të pa bazuar ankesën e prokurorisë, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoi.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.326/2017, të datës 03.07.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të aprovohet, aktgjykimi i ankimuar të anulohet ose të ndryshohet dhe të akuzuarin ta shpallë fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, si dhe t'i konfiskohet vetura e tipit 'Golf IV', ndërsa përgjigje në ankesën e prokurorisë të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK, ka mbajtur seancën e kolegjit, por nuk i ka ftuar palët në procedurë, sepse të akuzuarit nuk i është shqiptuar dënim me burgim.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, të Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë, përgjigje në ankesën e prokurorisë të mbrojtësit të akuzuarit, pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë, është e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, duke pasur parasysh se aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, por e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Prokuroria me ankesë e atakon aktgjykimin e ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se në veprimet e të akuzuarit nuk qëndrojnë elementet e veprës penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge, nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, sepse nga provat materiale dhe nga dëshmia e dëshmitarit Visar Jashari nuk është vërtetuar se i akuzuari është përdorues i substancave narkotike, si dhe nuk është vërtetuar se paratë kanë qenë të

prindit të akuzuarit, se nuk ka poseduar ndonjë dokument se këto para i ka sjellur nga Belgjika.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka gjetur, me datën 12.07.2016 rreth orës 00:20 minuta pas mesnatës, në rrugën “Bashkimi Kombëtar” në Mitrovië, policia e kishte ndaluar të akuzuarin B.F. duke e vozitur veturën tipit “Golf 4 “ me targa Belge dhe gjatë bastisjes në qantën e krahut i kishte gjetur dy paketime me substanca narkotike të llojit kanabis (marihuanë) në peshë të përgjithshme prej 7.67 gram.

Ashtu që nuk është kontestuese se natën kritike, policia gjatë bastisje e kishte gjetur atë sasi të substances narkotike, por me asnjë prove nuk është vërtetuar, se i akuzuari këtë sasi të substances narkotike e kishte për shitje, siç pretendon prokuroria se nuk janë gjetur sendet tjera që do të vërtetonin se i akuzuari kishte për qëllim që të shes substance narkotike, si peshorja, pajisjet për mbështjellje të narkotikëve, si dhe nuk është identifikua blerësi, kurse prokuroi nuk ka arritur të dëshmon se i akuzuari nuk ka qenë konsumues i narkotikve, andaj, pretendimet e prokurorisë janë të pa bazuara.

Prokuroria pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e ligjit penal, kur ka bërë ricilësimin e veprës penale, nga vepra penale blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPRK-së, në veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge, nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, si dhe kur ka vendosur që të akuzuarit të ia kthejë veturën, se vetura është përdorur për të transportuar substancë narkotike, si dhe të hollat në shumë prej 780 euro

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar ligjin penal, kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale posedim të e paautorizuar të substancave psikotropike dhe analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, për të cilën vepër penale e ka shpallur fajtor të akuzuarin, ashtu që gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar dispozitat e ligjit penal edhe kur të akuzuarit ja ka kthyer veturën si dhe të hollat të cilat i ka posedur, sepse kur nuk është vërtetuar vepra penale sipas aktakuzusës, adhere nuk mund të konfiskohen edhe sendet e pretenduara nga prokuroria.

Prokuroria ne ankesë pretendon se, gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit të akuzuarit, i ka shqiptuar dënim të ulët me të cilin dënim nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, që në të ardhmen most të përserisë vepra tjera penale.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit të akuzuarit, ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese, se i akuzuari ka pranuar se pa leje dhe autorizim ka poseduar substance narkotike, se më parë nuk ka qenë i dënuar, pendimin për veprën e kryer penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përserisë vepra tjera penale, moshën e re të akuzuarit, sasinë e vogël të narkotikëve, kurse si rrethanë rënduese e ka marrë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, se veprat e tilla janë në rritje e sipër.

Kjo gjykatë gjenë se, gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar në llojin dhe

lartësinë e dënimit, e si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh, sjelljen e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, se më parë nuk ishte i dënuar, ka shpreh pendim të thellë për vepërn e kryer penale, moshën e re, ka pranuar se pa leje dhe autorizim ka poseduar substance narkotike, e duke i pasur parasysh të gjitha këto rrethana lehtësuese i ka shqiptuar dënim me kusht dhe me të holla. Prokuroria në ankesë nuk cekë rrethana tjera rënduese, përveç se me dënimin e shqiptuar nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e prokurorisë në ankesë janë të pa bazuara, se dënimi i shqiptuar të akuzuarit B.F., është në proporcion me shkallës e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikojë edhe në personat tjerë që të mos kryejnë vepra penale, me të cilat dënime ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 401 të KPPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.3372/2017 me 10.08.2017

Procesmbajtësja,

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit,

1.Have Haliti,_____

2.Abdullah Ahmeti,_____

Kryetari i kolegjit,

Fillim Skoro